



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 520/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala, kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) paraqitur kundër kryesuesit të Qendrës së Votimit 1824e ne Besianë për shkak te parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV).

Arsyetim

PZAP-i , më datën 04.11.2013, ka pranuar ankesë nga Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendohet se me datën 3 nëntor rreth orës 07:10 në qendrën e votimit 1824e konkretisht në vendvotimin nr. 9 vëzhguesi Faruk Ismajli deklaroi se kutitë e votimit nuk kanë shenja identifikuese dhe nuk mund të bllokohen pasi që mekanizmi i tyre konkretisht kapaket janë të prishura dhe lidhur me këtë është njoftuar kryetari i KKZ-së Islam Demolli.

Lidhur me këtë çështje PZAP- i në cilësin e dëshmitarit mori në pyetje kryesuesin e KKZ Islam Demolli i cili në mënyrë kategorike i mohoi pretendimet e LVV-së dhe se sqaron se procesi ka shkuar gjithçka në rregull dhe se i gjithë materiali ka qenë në rregull dhe se nuk është e vërtetë ajo se ka qenë i njoftuar lidhur me atë çka pretendon LVV-ja.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apeloohen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Pretendimet ankimore nga ana e LVV-se në QV 1824e konkretisht në vendvotimin nr. 9 se kutit e votimit nuk kanë shenja identifikuese dhe nuk mund të bllokohen pasi që kapakët e tyre janë të prishura, PZAP-i konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar nga shkakun se nga veprimet e ndërrmara nga PZAP-i në drejtim të vërtetësisë së shkeljes së pretenduar si dhe nga deklarata e kryesuesit të KKZ-së dhënë PZAP-it se nuk ka qenë i njoftuar për këto shkelje dhe se gjithçka ka qenë në rregull PZAP-i konstaton se me këtë rast nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 520 /2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridike: *Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*